

THE CONTEMPORARY RECEPTION OF SARTRE'S WORK

Dëfrim SALIU

University of Tetova, Faculty of Philology, French Language and Literature

dëfrim.saliu@unite.edu.mk

Avdi VISOKA

University of Prishtina „Hasan Prishtina“, Faculty of Philology, French Language and

Literature

avdi.visoka@uni-pr.edu

UDC 821.133.1.09

Professional paper

Abstract

The reception and reflection of Jean-Paul Sartre for more than half a century since his death proves that he was an important personality of his era and a figure that remains actual even today. It was excessively difficult to be simultaneously a philosopher, professor, journalist, novelist, literary and art critic, dramatist and a biographer, in the period between the two world wars; and in that scheme, to also be a man of politics, considered as a „total intellectual“ by his contemporaries. His name, at times, becomes synonymous with a specific era. Sartre was a tireless human being, always in a mental and physical movement or „homme en marche“, as he was described by Simone de Beauvoir.

Keywords: *Reception, actuality, Sartre, existentialism, French literature.*

Përbledhje

Receptimi dhe reflektimi i Jean-Paul Sartre-it afër mbi gjysëm shekulli që nga vdekja e tij, dëshmon se ai ishte personalitet i rëndësishëm i epokës së tij dhe një figurë që mbetet aktuale edhe sot. Nuk ishte aspak e lehtë që në kohën në mes dy luftërave botërore të ishe njëkohësisht filozof, profesor, gazetar, romancier dhe kritik letrar e i artit, dramaturg dhe biograf. Dhe në gjithë këtë edhe njeri i politikës, i trajtuar si „intelektual total“ nga ihtarët e kohës së tij. Emri i tij nganjëherë bëhet edhe sinonim i një kohe. Sartre-i ishte njeri që nuk dinte të pushojë, çdoherë ishte në lëvizje mendore dhe fizike apo „homme en marche“, kështu e përshkruante Simone de Beauvoir-i.

Fjalët kyçë: *Receptimi, aktualiteti, Sartre, ekzistencializmi, letërsi frëngje.*

Hyrje

Aktualiteti ynë ndonjëherë trajtohet si „shekull i Sartre-it“¹ prej ithtarëve të tij, por shihet edhe vetëm si një „reflektim“ nga kritikët e tij. Por, një gjë tashmë mund të thuhet: ai ishte njëri prej personaliteteve më kontraverse të shekullit XX. Mirëpo, kjo aspak nuk e cënon talentin e tij. Ai ishte ndër ata intelektualë që patën guximin të pranojnë gabimet e tyre. Dhe, në kontekstin kulturor shqiptar, ky do të ishte mësimi që do duhej nxjerrë intelektuali i sotëm.²

Sartre-i si përfaqësues kryesor i ekzistencializmit frëng në vitet e paraluftës dhe pas Luftës së Dytë Botërore viziton shumë shtete europiane, por edhe më gjerë. Përveç angazhimit në letërsi, në revistën *Temps modernes* ai botoi shumë artikuj që trajtonin çështje nga politika. Këta artikuj shprehin pikëpamjet e tij mbi luftën e Koresë, çështjen e Kongos, Indokinës, Vietnamit, Kubës, Hungarisë, Hiroshimës etj.

Receptimi i sotëm letrar i Sartre-it

Receptimi letrar si fenomen letrar e ka zanafillën nga estetika e receptimit që kulmin e saj e arriti në vitet '60. Kanë kaluar gjysëm shekulli që nga vdekja e Sartre-it, por personaliteti i tij është i rëndësishëm si për epokën e tij ashtu që mbetet aktual edhe sot.³ Për të kuptuar receptimin e tij në letërsi, duhet nisur që nga angazhimi i Sartre-it, që fillimisht ishte gjenerator i kreativitetit të tij, shndërrohet në angazhim social dhe krijimtaria letrare e filozofike vehet në plan të dytë. Për pasojë asgjë e filluar në krijimtarinë e tij nuk e pa fundin e vet.

Paradoksi i parë i Sartre-it përfshinte demagogjinë sartriane për veprën e tij të pakryer si „të hapur“. Paradoksi i dytë është se ai e ktheu letërsinë në instrument lufte për t'i mbrojtur qëndrimet e tij të dala nga ky angazhim. Vetë lindja e Sartre-it koïcidon me shpërthimin e Revolucionit Rus, njërit prej Revolucioneve më të përgjakshme dhe më të errëta të qytetërimit tonë.⁴ Përsëri për koïncidencë, në fundvitet e '30-ta, kur po „përgatitej rendi i ri i vlerave“ erdhë njëri prej diktatorëve më të tmerrshëm që kishte parë njerëzimi në atë kohë, siç ishte Stalin-i, ndërsa karshi tij tashmë Hitler-i kishte filluar implementimin e megaprojektit të tij.

Ndërsa ekzistencialistët gjermanë, nxënës i të cilëve ishte Sartre-i, heshturazi po rreshtoheshin pas ideologjisë fashiste. Sartre-i si mendimtar diti t'i ruajë distancat në raport me

¹ Bernard-Henri Lévy, *Le Siècle de Sartre*, Grasset, Paris, 2000, fq. 115.

² Avdi Visoka, *Koha e shkrimit*, 99-AIKD, Prishtinë, 2011, fq. 120.

³ Sylvia Gerritsen & Tariq Ragi, *Pour une sociologie de la réception*, L'Harmattan, Paris, 1998, fq. 14.

⁴ Gilles Vannier, *L'existentialisme*, L'Harmattan, Paris, 2001, fq. 79.

teoritë marksiste e komuniste, por gjithnjë duke ju qëndruar si shoqërues i rrugës.⁵ Filozofia e tij quhej ekzistencialiste, ndonëse ai nuk gjendej në originë të ekzistencializmit, madje edhe pse vetë idetë sartriane nuk kishin shumëçka të përbashkët me idetë kirkegardiiane dhe me ato të shkollës ekzistencialiste gjermane.

Motoja kryesore të cilës i qëndroi Sartre-i ishte: „Dhuna mund të arsyetohej për të krijuar rendin e ri të vlerave ku ajo më nuk do të ishte e nevojshme“. Kjo nuk e largoi aspak nga bindjet e tij, edhe pse më vonë ai u thye më rusët proletarë pas intervenimeve të tyre të përgjakshme mbi popujt e vegjël që nuk pranonin t'u bindeshin idealeve komuniste.⁶ Përkundrazi, ajo premisë e orientoi atë kah Lideri i ri që po e „trasonte rrugën kah rendi i ri“ - Kina popullore. Tani e tutje, shkolla ekzistencialiste e Saint-Germain-it e denonconte terrorin stalinist, duke mbështetur gjithnjë e më afér maoizmin.

Miti i Sartre-it u ndërtua mbi kundërvënien e dy figurave të mëdha të epokës së tij, si Albert Camus-së dhe Raymond Aron-it, fillimisht miq të tij. Pas gjysëm shekulli, kjo kundërvënie e tij njëkohësisht shpreh edhe fizionominë e vërtetë të tij prej njeriu, intelektuali e politikani nga njëri prej partizanëve të tij nga e majta intelektuale franceze. Megjithatë është më mirë ta kemi gabim me Sartrin sesa të kemi të drejtë me Camus-në, ai nuk mund të hesht para konceptimeve të lajthitura politike të Sartre-it: „Sartre-in apo Camus-në? Camus-në, sigurisht. Bujarinë e tij. Fisnikërinë e tij“.⁷

Shikuar më vonë politikisht, nga këndi i pozicioneve të mirëfillta politike të mbrojtura nga njëri dhe nga tjetri, po ashtu nuk ka pyetje. Përballë skandalit totalitar, përballë kësaj sfide që u ofrohet intelektualëve dhe që u ndihmon se si të dinë të njohin a jo, barbarinë me ftyrat e tjera të saj, dhe janë vetëm në anën e Camus-së, fryma e revoltës dhe nderit. Është ai, Albert Camus, autori i *Njeriut të revoltuar*, që i dëgjon dëshmitë e Arthur Koestler-it ose të Margarete Buber-Neuman-it. Është po ai që, më 1951, kur Ceszlaw Milosz-i e braktisi Poloninë komuniste dhe që kokat e mençura të të majtës zyrtare e trajtojnë si një qen, ia zgjati dorën ndihmëprurëse. Tzvetan Todorov-i kur flet për rolin e intelektualit, dallon dy perspektiva që kundërvihen mes veti: atë të intelektualit si udhërrëfyes për të qenë syçelë dhe tjetren, atë të intelektualit si ushqyes shpresash.

Ai e vendos Sartre-in në perspektivën e dytë. Përpjekjet e Sartre-it me këtë rast kanë të bëjnë me utopizmin: konceptimin e një stadi ideal të njerëzimit si dhe përpjekjen për ta realizuar

⁵ Avdi Visoka, *Shkrim dhe receptim*, SHB Faik Konica, Prishtinë, 2016, fq. 103.

⁶ Avdi Visoka, *Koha e shkrimit*, 99-AIKD, Prishtinë, 2011, fq. 122.

⁷ Germaine Brée, *Camus and Sartre*, Delta Books, New York, 1972, fq. 58.

atë mbi tokë. Sigurisht, utopitë kanë ekzistuar gjithmonë, vazhdon më tej Todorov-i, por nga Platon deri te Rousseau-i, ato kishin për funksion të edukonin mendjen për t'i dhënë mundësi të analizonte botën, dhe jo të projektonte plane për teknokratët e së ardhmes. Sartre-i kërkonte që roli i intelektualit të jetë që të ngjallë besimin dhe jo të frymëzojë flijimin për një çështje të drejtë.⁸

Por, a nuk është synim i çdo utopizmi, vendosja e parajsës në tokë - të mos themi i parealizueshëm, por i dëshiruar?⁹ Dhe ajo që duhet dënuar nuk është vetëm mbjellja e ëndrrës së re në një vend, por vetë arsyetimi që shpie detyrimisht qoftë në braktisje në gjysmë të rrugës, qoftë në një përfundim siç është terrori. Sipas Todorov-it a duhet të shndërrohet intelektuali në përques shpresash dhe a duhet të bëhet mbrojtës i të mirës sovrane? Në këtë botë ku e mira dhe e keqja absolute ndeshen rrallë, ndihmesa e tij më e mirë do të ishte në dallimin ndërmjet të mirës dhe të keqës, na sugjeron Todorov-i.¹⁰

Aktualiteti i veprës së Sartrit në botë

Roli i Sartre-it në Francë shihet në shumë lëmi të jetës publike. Sartre-i ishte për shumë vite fenomen kryesor i jetës letrare në Francë, ndikimi i të cilët nuk ushtrohej vetëm në letërsi, por edhe në lëmi të tjera. Në fund të vitit 1944, Departamenti Amerikan i Shtetit kishte ftuar disa gazetarë francezë për t'i vizituar SHBA-të. Duke qenë gazetar i *Figaro*, Sartre-i nga janari deri në mars 1945 qëndroi në New York, Hollywood, Baltimore dhe New Orleans, mirëpritet si hero i rezistencës franceze.

John Gerassi shkruan se Sartre-i ka bërë më shumë se çdo kush nga bota intelektuale për denoncimin e padrejtësisë dhe mbështetjen e të varfërve në të gjithë botën.¹¹ Edhe pse disa shtete ishin afër apo kufizoheshin me Francën, roli dhe ndikimi i ekzistencializmit në këto shtete ishte i dobët. Në Hollandë ndikimi i fuqishëm i filozofisë ekzistencialiste dhe letërsisë së Sartre-it mori hov pas Luftës së Dytë Botërore. Filluan të mbahen seminare kushtuar filozofisë së Sarte-it dhe shumë artikuj u botuan në revista letrare edhe filozofike.

Sartre-i e vizitoi Hollandën në vitin 1946, kur ai ishte në kulmin e famës së tij. Më 7 dhjetor 1946 organizohet një konferencë në Universitetin e Utrecht-it, ku do të mbaj një fjalim.

⁸ Bernard-Henri Lévy, *Le Siècle de Sartre*, Grasset, Paris, 2000, fq. 256.

⁹ Avdi Visoka, *Shkrim dhe receptim*, SHB Faik Konica, Prishtinë, 2016, fq. 106.

¹⁰ Avdi Visoka, *Koha e shkrimit*, 99-AIKD, Prishtinë, 2011, fq. 125.

¹¹ John Gerassi, *Sartre, conscience haïe de son siècle*, Rocher, Monaco, 1992, fq. 133.

Zgjodhi Utrecht-in në vend të Amsterdamit, që është qendra e kulturës së vendit. Aty ndodhej, fal profesor David Jacob Van Lennep që e kishte ftuar Sartrin në këtë qytet ku ai ishte si profesor në Universitetin e Utrecht-it, këtë vizitë e thekson në veprën *Fjalët*, por aty shkruan se në vitin 1948, që është një lëshim apo gabim i vitit të vizitës të Utrecht-it.¹²

Çështja e ndikimit të kësaj vizite ishte në kuadër të receptimit të mendimit të Sartre-it në Hollandë. Historia e receptimit të Sartre-it në Hollandë fillon pas vitit 1945. Sigurisht, Sartre-i kishte publikuar një roman, një përbledhje me novela dhe shumë studime filozofike përgjatë luftës. Por, të gjitha këto kishin kaluar pa u vërejtur. Ishte i vetmi shkrimtari Simon Vestdijk i cili ishte i impresionuar pas Sartre-it.

Me rastin e publikimit të romanit *Neveria*, ai do të shkruajë më 14 maj 1938 në *Nieuwe Rotterdamsche Courant*: „Nëse nuk gaboj, për kohë shumë të shkurtër Sartri do të jetë njeri nga shkrimtarët më të mëdhenj të Francës që ka pasur ndonjëherë“.¹³ Lufta e Dytë Botërore ishte shkatërruese për Europën në kuptimin material, por edhe në kuptimin moral, intelektualët europianë ishin lodhur nga çdo formë e idealizmit. Mbi 55 milion njerëz u vranë, duke përfshirë këtu edhe 6 milion hebrej, të cilët u vranë vetëm për shkak të racës së tyre.

Prej vitit 1948 deri 1967, ekzistencializmi sartrian ishte modë edhe në Lindjen e Mesme. Sartre-i thirret nga nacionalistët laikë të Baath-it në Pakistan, që ishin anëtarë të shoqërisë arabe për të kundërshtuar komunizmin dhe islamizmin për të mos pasur dominim në rajonin e tyre. Këto reagime ishin shumë pozitive edhe në mesin e lexuesve arabë të Levant-it në Irak. Në veprat e Sartre-it gjetën përgjigje për ankthin që u kishte ngjallur nga humbja e Palestinës dhe duke vlerësuar filozofinë e lirisë.¹⁴

Ndikimi i Sartre-it në Lindjen e Mesme, u prit me entuziazëm deri në vitin 1967, kur ai u pushua nga kjo zonë kulturore, për qëndrimin e tij pro-izraelitë për të ashtuquajturën lufta Gjashtë ditore, i dha atij reputacionin e mohimit të mendimit të tij dhe të jetë i lirë nga çdo mirëkuptim politik. Në vitin 1960 vizitoi edhe Kubën, ku qëndroi nga 22 shkurt deri 20 mars. Aty, pati mundësi të takohet me Ernesto Che Guevara-n, sepse ishte përkrahës në mënyrë aktive i revolucionit kuban, si edhe shumë intelektualë të botës.

Por, në vitin 1971 prish raportet me Fidel Castro-n për arsyen e burgosjes së poetit kuban Heberto Padila për arsyen e kritikave të tij ndaj regjimit. Por, ndikimi i tij në Bashkimin Sovjetik shihet nga leximi i veprave të tij për filozofinë komuniste, gjegjësisht marksizmin. Përkthimi i

¹² Zhan-Pol Sartr, *Fjalët*, Fan Noli, Tiranë, 2006, fq. 219.

¹³ www.revue-relief.org/articles/10.18352/relief.39/galley/38/

¹⁴ Bernard-Henri Lévy, *L'Esprit du judaïsme*, Grasset, Paris, 2016, fq. 115.

veprave të Sartre-it në gjuhën ruse dhe deri te cenzurimi i disa veprave si *Duart e ndyra* (Les Mains sales).¹⁵ Prej vitit 1962 deri 1966 ai bashkë me Simone de Beauvoir-in, rrregullisht vizituan shumë herë Bashkimin Sovjetik.

E vizitonin gjatë verës për arsy që mos ndeshen me dimrin e fortë rus dhe atë nëntë herë radhazi vizituan këtë vend. Udhëtimi i parë i Sartre-it ishte në Moskë, Leningrad, pastaj në Uzbekistan, Estoni, Armeni dhe shumë republika tjera sovjetike. Por, kur u kthyte në Francë ai u sulmua ashpër nga gazetarët. Komentet e tij për Bashkimin Sovjetik i befasuan të gjithë. Në pesë intervista në mes 15 dhe 20 qershor të vitit 1962 në të përditshmen *Libération* u shfaqen si një lëvdatë e madhe e adresuar Bashkimit Sovjetik.

Përfundimi

Ajo që e bëri Sartre-in që të bjerë në sy të kritikëve letrarë të kohës së tij, ishte edhe refuzimi i çmimit „Nobel“ në vitin 1964. Në autobiografinë e tij dhe idetë që i hedh për të ndriçuar historinë e jetës së tij, pastaj angazhimi i tij për paqe dhe liri, mendojmë se plotësisht e meritonte këtë çmim. Por, problemi qendron në raportin midis krijimtarisë së lirë njerëzore dhe simbolikës së njohur institucionale.

Sipas perceptimit të tij të botës apo filozofisë së tij, veprimtaria njerëzore nuk mund të ngurtësohet në asnjë simbol, sado i lartë, sado i vlerësuar, sado i madh qoftë ai, sikurse ishte çmimi „Nobel“. Në këtë raport midis lirisë njerëzore dhe institucionit, ai ka frikë të mos ndërhyjë institucioni në personin dhe pastaj ta tjetërsojnë atë duke e kaluar në publik në forma të tjera që i dalin nga kontrolli autorit.

Në një konferencë kushtuar Sartre-it në vitin 2009, pyesin se ku mund të ishte Sartre-i sot?, Pierre Besses thotë: „Po të ishte Sartre-i sot, ai do të ishte bashkë me punëtorët që shtypen në mënyrë të ndryshme nga aksionarët e kompanive gjigante në SHBA, në Fort-de-Francë për emancipimin e Guadeloupe-s dhe Martinique, apo në Tribunalin Ndërkombëtar të Hagës, krah viktimave të gjenocidit serb në Srebrenicë“.¹⁶

¹⁵ John Gerassi, *Sartre, conscience haïe de son siècle*, Rocher, Monaco, 1992, fq. 55.

¹⁶ <http://www.grep-mp.com/wp-content/uploads/2016/10/18-Sartre.pdf>

Bibliografia

- SARTR, Zhan-Pol (2006). *Fjalët*, Tiranë: Fan Noli.
- BRÉE, Germaine (1972). *Camus and Sartre*, New York: Delta Books.
- DE BEAUVOIR, Simone (1986). *La force de l'âge*, Paris: Gallimard.
- GERASSI, John (1992). *Sartre, conscience haïe de son siècle*, Monaco: Rocher.
- GERRITSEN, Sylvia & RAGI, Tariq (1998). *Pour une sociologie de la réception*, Paris: L'Harmattan.
- KAUFMANN, Walter (2011). *Ekzistencializmi nga Dostojevski te Sartri*, Tiranë: Plejad.
- LÉVY, Bernard-Henri (2000). *Le Siècle de Sartre*, Paris: Grasset.
- LÉVY, Bernard-Henri (2016). *L'Esprit du judaïsme*, Grasset.
- VANNIER, Gilles (2001). *L'existentialisme*, Paris: L'Harmattan.
- VISOKA, Avdi (2011). *Koha e shkrimit*, Prishtinë: 99-AIKD.
- VISOKA, Avdi (2016). *Shkrim dhe receptim*, Prishtinë: Faik Konica.